



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi Komunal Rahovec / Skupština Opštine Orahovac / Municipal Assembly Rahovec



Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit

Uprava za Urbanizam, Planiranje i Zastitu Okoline

Department for Urbanism, Planning and Environmental Protection



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbr. i Mjedisit
Odeljenje za Urbanizam, Planiranje i Zašt. Sredine

-XII- Nr. i prot. 83
Br. 07.04.2025
RAHOVEC - ORAHOVAC

RAPORTI TREMUJOR I PUNËS

JANAR-MARS 2025

DREJTORIA PËR URBANIZËM, PLANIFIKIM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

DREJTORIA PËR URBANIZËM, PLANIFIKIM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, ushtron përgjegjësitë që i ka Komuna sipas dispozitave duke u bazuar në obligimet që dalin nga Ligji Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Ligji Nr.04/L-110 për Ndërtim, Ligji Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, Ligji Nr.06/L-024 për trajtimin e Ndërtimeve pa Leje dhe Statuti të Komunës Nr. 1005 i datës 29.03.2017. Raport në bazë të punëve të cilat janë realizuar gjatë vitit 2022 nga Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit

Në kuadër të Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit funksionojnë dy sektorë,

- Sektori i Urbanizmit dhe Planifikimit,
- Sektori i Mbrojtjes së Mjedisit

Në tremujorin e parë në vitin 2025 në Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit janë pranuar gjithësej 85 kërkesa të ndryshme, prej tyre 77 sektorin e Urbanizmit dhe Planifikimit, 8 kërkesa në sektorin e Mjedisit, lëndë të zgjidhura janë 67.

Të hyrat buxhetore në DUPMM (tremujori i parë) për vitin 2025

Viti	2025
Të hyra Janar- Mars	5981.14

SEKTORI I URBANIZMIT DHE PLANIFIKIMIT

Në vitin 2025 zyrtarët e Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit nga sektori për Urbanizëm dhe Planifikim janë angazhuar në lehtësimin e procedurave për aplikimin e lejeve të ndërtimit, kërkesave të qytetarëve, investitorëve. Në aspektin e planifikimit hapësinor dhe urban brenda afatit ligjor janë trajtuar kërkesat, janë dhënë kushtet e ndërtimit dhe lejet e ndërtimit për objektet të cilat janë në harmoni me planet urbanistike që janë të miratuara në Kuvendin e Komunës, sipas Planit Zhvillimor Komunal në fuqi. Për marrjen e kushteve ndërtimore dhe lejes së ndërtimit janë dorëzuar së bashku me dokumentacionet e nevojshme edhe projektet ideore dhe projektet zbatuese të cilat janë pranuar nga zyrtarët përgjegjës, me ç'rast është bërë kontrollimi i tyre. Po ashtu janë dhënë edhe pëlqime. Me vendim të kryetarit të datës 15.09.2022 janë emëruar dy zyrtar përgjegjës për mbikëqyrjen e kërkesave për leje ndërtimore, leje rrënimi dhe kushtet e ndërtimit.

Në sektorin e Urbanizmit dhe Planifikimit janë shqyrtuar:

Janar - Mars 2025					
Kërkesat	Nr.total	Aprovuar	Refuzuar	Në shqyrtim	Hudhet
Leje ndërtimi	4	4	0	0	0
Leje përdorimi	0	0	0	0	0
Leje rrënimi	5	3	0	2	0
Kushte ndërmorë	32	23	0	8	1
Shkresë	29	22	0	7	0
Pelqim	4	3	1	0	0
Legalizim i objekteve	3	3	0	0	0
Gjithësej	77	58	1	17	1

Të hyrat e përgjithshme Janar - Mars 2025

Parallogaria	1918.52€
Vertetim –Pelqim	155€
Legalizim	2535.32€
Totali i të hyrave	4608.84€

SEKTORI I MJEDISIT

Në bazë të Sektorit të mjedisit leshojmë Leje mjedisore Komunale dhe Leje Ujore Komunale.

Janar - Mars 2025					
Kërkesat	Nr.total	Aprovuar	Refuzuar	Në shqyrtim	Hudhet
Leje Mjedisore Komunale	7	6	1	0	0

Shkresë	1	6	0	0	0
Gjithësej	8	6	1	0	0

Totali i të hyrave	1372.30 euro
---------------------------	---------------------

Hartimi i Hartës Zonale të Komunës

Harta Zonale është dorëzuar në Ministrinë përkatëse për marrjen e miratimit dhe zhvillimin e procedurave të nevojshme për hapjen e shqyrtimit publik të Hartës Zonale të Komunës. Ky proces është një hap i rëndësishëm në realizimin e planifikimit të qëndrueshëm të territorit dhe përmirësimin e menaxhimit urban, duke mundësuar që qytetarët dhe palët e tjera të interesuara të kenë mundësinë të kontribuojnë në diskutimin dhe shqyrtimin e propozimeve të paraqitura. Së miratimit nga Ministria, do të fillojë faza e konsultimeve publike, ku qytetarët dhe ekspertët do të kenë mundësinë të shqyrtojnë hartën dhe të shprehin mendimet, sugjerimet dhe shqetësimet e tyre për sa i përket propozimeve të parashikuara në Hartën Zonale.

Ndërtimi i Sheshit Qëndror në Qytet

Punimet në Sheshin Qendror po vazhdojnë me ndërtimin e Unazës, një projekt i rëndësishëm për zhvillimin urban. Gjatë tremujorit të parë të vitit 2025, janë realizuar avancime të dukshme, ndërtimi i unazës, ndërtimin e ishujve gjelbërues, amfiteatrit dhe rregullimi i hapësirës. Punimet janë zhvilluar me ritëm të mirë, duke siguruar një progres të qëndrueshëm dhe në përputhje me afatet e parashikuara. Ky projekt synon të krijojë një hapësirë moderne dhe funksionale, që do të shërbejë si një qendër e rëndësishme për qytetarët, duke ofruar mundësi për rekreacion dhe aktivitete sociale.

Qendrën e sheshit në formë rrethore;
 Parkingun nëntokësor dhe mbitokësor;
 Tregun ditor;
 Shtegun për biçiklistë;
 Shtegun për këmbësorë;
 Lokale afariste dhe
 Hapësira të gjelbra.

Ballkoni Panoramik

Në projektin e ballkonit panoramik, gjatë tremujorit të parë të vitit 2025 janë realizuar disa punime të rëndësishme. Pllatoja e ballkonit është veshur me gur dekorativ, hapësira e perapër për gjelbrim është mbushur me dhe, dhe janë mbjellur drunjtë dekorativ për të krijuar një ambient më të gjelbër. Është vendosur infrastruktura nëntoksore për energji elektrike dhe sistem të ujit, po ashtu, janë vendosur shtyllat e ndriçimit, duke siguruar një ndriçim të përshtatshëm për këtë hapësirë. Kompania e angazhuar po punon gjithashtu për përgatitjen e konstruksionit metalik, i cili do të përmbyllë projektin e ballkonit panoramik.

Sistemi i Adresave

Në kuadër të Drejtoris për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, në bashkpunim me Agjencinë Kadastrale të Kosovës, është angazhuar Stafin Mbështetës për rrjedhat e procesit të Kompletimit të Sistemit të Adresave, detyrë e zyrtarit të angazhuar është harmonizimin emrave të rrugëve në ARIS, ndryshimin e formave të rrugëve (ndarje/bashkim kodesh), kontrollën e hyrjeve sipas metodologjisë së caktuar dhe përgatitjen në statusin “gati për aprovim” për t’i paraqitur në Gjeoportal dhe shfrytëzim nga qytetarët dhe institucionet. Po ashtu po vazhdon vendosja e numrave të hyrjeve me Agjencinë Kadastrale të Kosovës.

Projektet e përfunduar gjatë vitit 2024

- Ndërtimi i Parqeve në Komunën e Rahovecit (Kramovik, Guri i Kuq, Çifllak , Brestoc, Drenoc, Xërxë, Pataqan i Epërm, Krushë e Madhe, Opterush -muret dekorative, Ratkoc, Fortes.
- Ndërtimi i shtratit të përroit në Polluzhë
- Ndërtimi i parqeve në Opterush, Retijë e Poshtme dhe kolektori për ujrë e zeza në Ratkoc dhe Rahovec
- Ndërtimi i ndërtesës së perbashkët për banim të familjeve me nevojë-Faza përfundimtare
- Bustet e Dëshmorve (Gëzim Hamza-Piktori, Sadedin Hajda dhe Mizahir Isma)
- Hartimi i Vlersimit Strategjik Mjedisor për HZK
- Hartimi i Planit të Vlersimit Mjedisor

Projektet në fazën e realizimit

- Ndërtim i Sheshit Qendror të Qytetit
- Ndërtimi i Ballkonit Panoramik, mbi qytetin e Rahovecit
- Ndërtimi i rrugës në qytet . Ibrahim Rugova, Rr. Xhelal hajda, Rr. Muharem Dina
- Ndërtimi i kolektorit dhe shtratit të lumit në Hoçë të Madhe, Brestoc, Hoçë e Vogël, Nagac dhe Krushë e Madhe.
- Trajtimi i shtretërve të përrenjeve në Komunën e Rahovecit- Faza e Parë
- Rregullimi i shtratit të lumit Rimnik - Fortesë
- Rregullimi i shtratit të lumit në Krushë të Madhe
- Hartimi i Hartës Zonale të Komunës së Rahovecit
- Ruajtja dhe trajtimi i vlerave të trashëgimisë kulturore dhe krijimi i sigurtisë së lëvizjes në qytetin e Rahovecit

